ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KUVENDI KOMUNAL VITI**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr i Prokurimit	**657-24-9348-5-1-1**
Nr i brendshëm	

Sa i përket tenderit për: **"**Asfaltimi i rrugëve rurale në komunën e Vitisë- Ritender**".**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

IDEOR CONSTRUCTION SH.P.K.

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Prishtine

(Adresa)

Prishtine — *(Vendi)*

10000 — *(Kodi postar)*

049237574 — *(Numri Telefonit)*

N/A — *(Numri i Faks-it)*

Durim Shala

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

ideorconstruction@gmail.com

(Adresa elektronike)

01.10.2024

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Data e njoftimit për kontratë: 14.09.2024 Hapja e ofertave, e planifikuar:04.10.2024

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☐

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐ **Jo** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☐ **Jo** ☐

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 27 i LPP-së
Neni 28 i LPP-së
Neni 69 i LPP-së
Neni 17 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik
Neni 25 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Data e njoftimit për kontratë është bërë me dt.14.09.2024, kurse hapja e ofertave është parashikuar të bëhet me dt. 04.10.2024.
Ne kemi analizuar dosjen e tenderit për këtë projekt dhe kemi vërejtur që ka shumë kërkesa dhe specifikime diskriminuese/favorizues dhe të panevojshme e që nuk përkojnë me natyrën e këtij aktiviteti të prokurimit.
Specifikimet që ne i kemi vërejtur e që janë diskriminuese/favorizuese dhe që kufizojnë konkurrencën janë tek ANEKSI 7; MJETET E PUNES - MAKINERIA

Tek aneksi 7 i dosjes së tenderit është kërkuar pajisja me nr. rendor 6. Eskavator deri 1 t – 1 copë. Eskavatori i kërkuar është i panevojshëm për këtë aktivitet të prokurimit, pasi që i njëjti nuk është në harmoni me punët të cilat janë paraparë të përfundohen në këtë aktivitet të prokurimit. Pajisja e lartcekur është kërkuar për të favorizuar një OE të caktuar i cili e posedon të njëjtën pajisje, mirëpo që në këtë aktivitet të prokurimit i njëjti është i panevojshëm, Kur analizohet aneksi 7 i dosjes së tenderit shihet se janë kërkuar 7 eskavatorë të tjerë të cilët mund ti përfundojnë të gjitha punët e

specifikuara në paramasën e këtij aktiviteti të prokurimit.
Andaj kërkojmë që të largohet në tërësi nga dosja e tenderit eskavatori deri1 ton, sepse po favorizohet një OE i caktuar, njëkohësisht po diskriminohen kompanitë me shumë përvojë të cilët janë të specializuar në fushën e asfaltimit dhe realisht ky ekskavator është i tepërt dhe i pa nevojshëm.

Tek aneksi 7 i dosjes së tenderit janë kërkuar edhe dy lloje të pajisjeve Pajisja me nr. rendor 7.Buldozer me lopatë 1-3 t – 1 copë dhe pajisja me nr. rendor 10.Kamionet kipper deri 1 t – 2 copë. Këto pajisje janë të panevojshme për këtë aktivitet të prokurimit dhe të njëjtat janë vendosur për të favorizuar një OE të caktuar i cili i posedon këto pajisje. Vetëm nëse analizohet tonazha e pajisjeve të lartcekura, kuptohet qartë se të njëjtat janë pajisje të panevojshme për këtë aktivitet të prokurimit, pasi që në këtë projekt janë kërkuar mjaftueshëm pajisje tjera të cilat i kryejnë punët e parapara në paramasë, ndërsa këto pajisje me tonazhën e kërkuar duhet të largohen në tërësi nga dosja e tenderit. Tonazha e përcaktuar e Buldozerit vetvetiu tregon për favorizim të hapur dhe kufizim të konkurrencës, prandaj duhet të largohet kërkesa për Buldozer nga dosja e tenderit.

Se pretendimet tona janë të qëndrueshme vërtetohet edhe me kërkesën **për kamionetat kiper të kërkuara**, pasi që të njëjtat nuk kryejnë ndonjë funksion më shumë në këtë aktivitet të prokurimit se sa 9 kamion të tjerë që janë kërkuar me kapacitet të mjaftueshëm dhe 4 kamioneta tjera për bartjen e punëtorëve, andaj është e pa arsyeshme kërkesa në lidhje me kamionetat kiper deri 1 ton. Realisht kemi të bëjmë me duplifikim të kërkesave pa asnjë arsye profesionale.

Autoriteti kontraktues me këto kërkesa po e favorizon haptas një OE të caktuar i cili i posedon pajisjet e lartcekura me tonazhën e specifikuar, pasi që pajisjet e kërkuara vetëm sa e stërngarkojnë dosjen e tenderit dhe ju pamundësojnë ofertimin OE të interesuar për këtë aktivitet të prokurimit.

Po ashtu tek aneksi 7 i dosjes së tenderit është kërkuar edhe pajisja me nr. rendor 12. Grejder minimum: 5 t me regjistrim – 1. Edhe kjo pajisje e kërkuar duhet të largohet në tërësi nga dosja e tenderit pasi që e njëjta është e panevojshme, kufizon konkurrencën dhe favorizon kompani të caktuara.

Kur analizohet dosja e tenderit shihet që tek aneksi 7 është kërkuar edhe një tjetër grejder me peshë min 11 ton, i cili është i mjaftueshëm për kryerjen e punëve të parapara për këtë aktivitet të prokurimit, mirëpo grejderi i kërkuar me tonazhë **prej min. 5 ton**, është i panevojshëm për këtë aktivitet të prokurimit dhe nuk përkon me natyrën dhe qëllimin e këtij tenderi. Edhe në këtë rast kemi duplifikim të kërkesave për pajisje pa asnjë arsye profesionale.

Po ashtu kërkojmë nga ana e AK-së që pajisjen me nr. rendor 15. Cilindër minimum 18 t – 1 copë, ta largoj në tërësi nga dosja e tenderit, për faktin se kjo pajisje e favorizon një OE të caktuar. Tek aneksi 7 i dosjes së tenderit janë kërkuar edhe **5 cilindra** të tjerë me pesha të ndryshme **nga min. 7 ton e deri në min. 17 ton**, andaj është e panevojshme të kërkohet edhe një cilindër dhe të specifikohet tonazha për cilindrin e lartcekur në minimum 18 ton, pasi që cilindrat tjerë të kërkuar janë të mjaftueshëm për të përfunduar

punë e parapara në paramasë të këtij aktiviteti i prokurimit. Pra kemi kërkesa për cilindër në kundërshtim me natyrën dhe vëllimin e projektit. E rëndësishme është të kryhen punimet sipas projektit, prandaj duhet të largohet kjo kërkesë dhe të trajtohen në mënyrë të barabartë të gjithë ofertuesit e të mos ketë kufizim të konkurrencës.

Tek aneksi 7 i dosjes së tenderit është janë kërkuar edhe pajisjet me nr. rendor 21. Finisher per shtrirjen e asfaltit, Maximum 7 t – 1 copë dhe pajisja me nr. rendor 22. Grryese e asfaltit – 1 copë. Kur analizohet paramasa e këtij aktiviteti të prokurimit shihet qartë se pajisjet e lartcekura nuk janë në harmoni me punët të cilat janë paraparë të përfundohen në këtë aktivitet të prokurimit dhe të njëjtat janë të panevojshme. Në aneksin 7 është kërkuar një finisher, i cili është i mjaftueshëm për këtë aktivitet të prokurimit, ndërsa finisheri të cilit i është përcaktuar tonazha max. 7 ton, është kërkesë e panevojshme, diskriminuese, prandaj duhet të largohet nga dosja e tenderit. Nuk ka asnjë arsye të kërkohen dy finishera e aq më pak të ketë kufizime të tonazhes në këtë mënyrë.

Ndërsa sa i përket **gërryeses së asfaltit,** mjafton të analizohet paramasa e këtij aktiviteti të prokurimit dhe atëherë kuptohet qartë se në asnjërin nga pozicionet nuk është specifikuar gërryerja e asfaltit, prandaj kjo pajisje e kërkuar është vendosur në dosje të tenderit me qëllim të favorizimit të një OE të caktuar, prandaj kërkojmë që të largohet nga dosja e tenderit kjo kërkesë.

Në numrin rendor 23 është kërkuar Mini damper deri 500 kg—1. Kjo kërkesë është plotësisht diskriminuese dhe nuk përkon me natyrën këtij projekti, e veçanërisht kur janë kërku edhe shumë pajisje të tjera që mund të kryhen punët edhe pa këtë damper. Kufizim ekstrem vërehet ku është cekur pesha deri 500 kg, prandaj kërkojmë që të largohet kërkesa për damper sepse realisht nuk ka nevojë për këtë pajisje në këtë projekt.

Në numrin rendor 24 është kërkuar Bucket 2-3 t -1 copë. Për neve është shumë e paqartë përse është kërkuar kjo pjesë/pajisje dhe se çfarë funksioni të veçante mund të kryhet me këtë pjesë/pajisje, prandaj kjo kërkesë është absolutisht e panevojshme dhe kërkojmë që të largohet nga dosja e tenderit.

Në numrin rendor 26 është kërkuar Mini 26. Cistern për karburante-1 copë, kurse në numrin rendor 27 Cisterne (tanket) e ujit-1. Të dy këto pajisje janë plotësisht të panevojshme për këtë projekt dhe janë vetëm kërkesa që mund të favorizojnë OE të caktuar dhe të kufizojnë konkurrencën, përndryshe janë plotësisht jo në harmoni me natyrën dhe qëllimin e këtij projekti.

Në numrin rendor 28 është kërkuar Kamion me kran me peshë bartëse deri 12 t-1, kurse tek numri rendor 29. Pikup për puntorë-4. Kërkesa për kamion me kran në këtë tender është jashtë natyrës së këtij projekti , prandaj nuk duhet të ekzistojë kjo kërkesë, në të kundërtën vetëm e kufizon konkurrencën dhe nuk ka ndonjë arsyeshmëri të jetë kërkesë e dosjes së tenderit. Kërkojmë që të largohet kjo kërkesë. **Ndërsa edhe kërkesa për 4 pikup** për punëtorë është kërkesë shumë kufizuese, e pa arsyeshme dhe nuk përkon me natyrën e këtij projekti. Nuk duhet të imponohen kësi kërkesa që nuk kanë rëndësi për projektin, ndërsa çështja e lëvizjes së punëtoreve është çështje e brendshme e organizimit

të kompanisë, prandaj duhet të largohet kjo kërkesë nga dosja e tenderit.

<u>Në numrin rendor rendor 31 është kërkuar Automikser betoni-3 copë, ndërsa tek numri rendor 32 është kërkuar Autobetonjer mikser-Autopompë-1 copë</u>. Edhe këto pajisje janë të panevojshme dhe janë kërkesa diskriminuese përkatësisht favorizuese për kompani të caktuara, prandaj duhet të hapet konkurrenca dhe të largohen këto pajisje të panevojshme.

Këto kërkesa në lidhje me pajisjet të cilat i kontestuam, janë hapur kurdisje e tenderit dhe tendencë favorizimi të një kompanie të caktuar, prandaj duhet ndryshuar për të pasur një aktivitet të suksesshëm dhe me konkurrencë të hapur.

Kërkojmë që të largohen kërkesat e kontestuara më lartë, me qëllim që të hapet konkurrenca dhe të mos ketë favorizime në këtë aktivitet të prokurimit. Nëse nuk largohen / ndryshohet kërkesat e lartcekura, atëherë ne këto kërkesa nuk mund ti kuptojmë ndryshe përveç se favorizim të hapur ndaj një kompanie të caktuar. Njëkohësisht me këto kërkesa po ju pamundësohet ofertimi OE me shumë përvojë në fushën e ndërtimit dhe gjithashtu po diskriminohen edhe OE të themeluar rishtazi.

Me këto kërkesa është përcaktuar fituesi në start të këtij publikimi, prandaj është e domosdoshme të largohen të gjitha kërkesat që i cekëm më lartë, në të kundërtën, ne do të jemi të detyruar ti ndjekim procedurat ligjore të ankimimit në organet administrative për favorizim dhe diskriminim të hapur në këtë procedurë prokurimi.

Me këto kërkesa të dosjes së tenderit, shihet qartë tendenca e dëmtimit **të buxhetit** të Komunës, sepse me këto kërkesa dihet qartë ftuesi i kësaj kontrate dhe normalisht që operatori ekonomik i cili i posedon këto dëshmi të kërkuara oferton me çmim maksimal dhe me këtë rast mund të dëmtohet buxheti i Komunës në masë ekstrem të madhe.

Ne me dt.30.05.2024 kemi pranuar vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, me arsyetimin se e njëjta është e pa bazuar, mirëpo autoriteti kontraktues nuk ka dhënë arsye konkrete për një refuzim të tillë, mirëpo vetëm ka bërë shmangie nga pretendimet tona ankimore.

Autoriteti kontraktues në vendimin e saj ka bërë shmangie nga pretendimet tona ankimore të cilat kanë qenë të arsyetuara, ndërsa AK-ja pasi që nuk ka mundur të arsyetoj të kundërtën e pretendimeve tona, është munduar të arsyetohet me fjalët "pretendimet tuaja janë një sorollatje llafesh", mirëpo nuk është dhënë asnjë arsyetim konkret sa i përket pretendimeve tona ankimore, mirëpo ka dhënë një arsyetim jo profesional dhe subjektiv.
E njëjta nga të gjitha pretendimet tona ankimore është munduar të jep një arsyetim vetëm tek pajisja Cisterna, mirëpo edhe në këtë rast nuk ka dhënë ndonjë arsyetim konkret. AK-ja e ka cekur se nuk është në leverdinë tonë duke u brengosur për shpenzimet që i bëhen operatorit ekonomik për transport dhe kinse humbim kohë. Ky arsyetim i AK-së është i pa bazuar pasi që operatorët ekonomik në momentin e dorëzimit të ofertës i marrin parasysh të gjitha shpenzimet dhe njëkohësisht e prezantojnë edhe deklaratën për afatin e përfundimit të punëve, andaj edhe nuk qëndron arsyetimi i tyre se humbet kohë dhe se OE kanë shpenzime.

Përveç cisternës autoriteti kontraktues për asnjërin nga pretendimet tjera nuk ka dhënë asnjë arsyetim, se përse të njëjtat janë të paqëndrueshme. E njëjta e ka cekur se pretendimet janë të pashpjegueshme sepse kinse kemi kërkuar të largohen 45% e

kërkesave të përgjithshme, mirëpo në momentin që kërkesat e specifikuara janë të panevojshme dhe diskriminuese/favorizuese për OE të interesuar në këtë aktivitet të prokurimit, atëherë ne kemi qenë të detyruar ti kundërshtojmë kërkesat e vendosura në dosje të tenderit.

Autoriteti kontraktues me veprimin e saj duke mos dhënë përgjigjje në pretendimet tona ankimore ka vepruar në kundërshtim të plotë me dispozitat ligjore të nenit 108/A paragrafi 9 i LPP-së, ku specifikohet qartë *"9.Refuzimi do të arsyetohet dhe do ti komunikohen me shkrim, në përputhje me këtë ligj, parashtruesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara, nëse ka ndonjë. Për më tepër autoriteti kontraktues mund të pengojë procedurën e mëtejshme, me pranimin e një njoftimi me shkrim nga ankuesi në lidhje me gatishmërinë e tij për të tërhequr kërkesën e paraqitur për shqyrtim".*

Këto kërkesa bien ndesh plotësisht me nenin 7 të LPP-së përkatësisht paragrafët 1, 2, 3 dhe 6. Paragrafi 1 i nenit 7 parasheh qartë që "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente". Me këto kërkesa, jo që nuk mund të ketë trajtim të barabartë të operatorëve ekonomik por do të ketë diskriminim të hapur dhe përcaktim të fituesit qysh në start të këtij aktiviteti të prokurimit, pa konkurrencë të hapur.

Paragrafi 6 i dispozitës së nenit 7 parasheh qartë : Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; (i) pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit". Me këto kërkesa nuk mundësohet pjesëmarrje e gjerë e operatorëve ekonomik, por në këtë mënyrë është kufizuar tej mase konkurrenca dhe këto kërkesa janë drejtpërdrejtë jo në harmoni me çmimin dhe lëndën e prokurimit, sepse kur kufizohet konkurrenca me kërkesa të pa nevojshme atëherë edhe çmimi ofertues i operatorëve ekonomik të favorizuar, automatikisht është shumë më i lartë sepse nuk kanë konkurrencë dhe faktikisht determinohet çmimi nga ana e autoritetit kontraktues në bazë të kërkesave të dosjes së tenderit.

Duke u bazuar në të gjitha dështimitë dhe kundërshtimet tona që u cekën më lartë, rezulton se dosja e tenderit nuk është përpiluar në harmoni me nenin 27 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është marr parasysh as neni 17.7 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik ku shkruan qartë që "Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë që nuk: Kufizon konkurrencën në mesin e OE, ose Diskriminon kundër ose vepron në favor të një ose më shumë OE-ve".

Kërkesat që u kundërshtuan më lartë, janë shumë favorizuese/diskriminuese dhe njëkohësisht ua mbyllin dyert e ofertimit shumë kompanive me eksperiencë në këtë fushë dhe gjithashtu këto kërkesa bijnë në kundërshtim edhe me nenin 25.4 të Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik, sepse aty shkruan qartë se "Gjatë përcaktimit të kërkesave minimale për kualifikim, AK do ti kushtoj rëndësi të veçantë zhvillimit të OE dhe do të formuloj kërkesat minimale të kualifikimit në mënyrë që nuk përjashton OE të themeluar rishtazi të cilët posedojnë aftësi të arsyeshme dhe të mjaftueshme ekonomike, financiare dhe/ose teknike".
Me këto kërkesa, jo vetëm që nuk i është kushtuar rëndësi operatorëve ekonomik të ri, por i është kufizuar konkurrenca edhe operatorëve ekonomik me përvojë dhe me stabilitet ekonomiko financiar dhe me aftësi teknike profesionale, prandaj duhet ndryshuar/larguar këto kërkesa që të mundësohet pjesëmarrje më e gjerë e operatorëve ekonomik në këtë aktivitet të prokurimit dhe të merret parasysh edhe dispozita e lartpërmendur (25.4 të Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik). Pra, në vend se të merret parasysh edhe

zhvillimi i operatorëve ekonomik të rinjë, janë diskriminuar hapur edhe operatorët ekonomik tjerë, me më shumë përvojë në këtë fushë siç është ky aktivitet i prokurimit. Pra është kufizuar konkurrenca.

Duke u bazuar në të gjitha ato kërkesa diskriminuese-favorizuese dhe në ato dëshmi të kërkuara, rezulton se këto kërkesa bijnë në kundërshtim edhe me nenin 1 të LPP-së-qëllimi i LPP-së, e ku shkruan qartë: Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke u bazuar në të gjitha faktet dhe dëshmitë që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP-ja që të merr:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE **IDEOR CONSTRUCTION SH.P.K.**
DETYROHET AK të bëj ndryshimin e kërkesave, që u cekën më lartë nga ana jonë dhe pastaj të veprohet konform nenit 53.7 të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmet materiale akoma nuk janë llogaritur sepse jemi në fazën e njoftimit për kontratë dhe fazën para ofertuese.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*